



Kolegji Riinvest
Zyra për planifikim akademik

Sistemet Financiare dhe Funkcionet e Bankave EKM0023

Bartësi i lëndës:	Alban Hetemi
Email:	alban.hetemi@riinvest.net
Telefoni:	+383 (0) 38 224 322

Hyrje

Kriza financiare globale dhe pasojat e saj demonstuan rëndësinë e bankave dhe sistemeve financiare për mirëqenien ekonomike si dhe rolin kryesor të parasë në ekonomi. Lënda "Sistemet financiare dhe funksionet e bankave" ofron një hyrje në studimin e parave, bankave, dhe tregjeve financiare. Lënda diskuton pse duhet studiuar parane, bankat dhe tregjet financiare si dhe ofrohet një pasqyrë e përgjithshme e sistemit financiar dhe koncepteve të tij. Prandaj, përmes kësaj lënde mëtohet t'iu ofrohet studentëve njohuri në fushën e parasë, bankave dhe sistemit financiar, përkatësisht tregjeve financiare dhe të kapitalit në përgjithësi përmes sqarimit të një sërë konceptesh bankare e financiare. Këto tema do t'iu ndihmojnë studentëve për ta konceptuar sistemin financiar dhe bankingun e sotëm modern. Ky kurs synon t'iu jap njohuri më të avancuara studentëve në kuptimin e sjelljes së sistemit financiar, tregjeve financiare e bankave si dhe të adresojë disa nga trendet kryesore në sistemin financiar si dhe bankingut.

Qëllimet

Qëllimi i lëndës është që t'iu sigurojë studentëve njohuri më të thella në teorinë dhe praktikën e sistemeve financiare e veçanërisht në bankingun e sotëm modern dhe perspektivat e tij. Lënda ofrohet në programin Master "MA – Menaxhimi i Sistemeve Financiare dhe Informatike". Studentët do të thellohen dhe zgjerojnë njohuritë në çështjet e bankingut modern. Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë: • kuptojnë rolin e sistemit financiar the tregjeve financiare në përgjithësi • kostot e informacionit dhe kërkesat për likuiditet; • shpjegojnë se pse bankat e konsiderojnë fitimprurës ndërmjetësimin në mes të huamarrësit dhe huadhënësit, • kuptojnë rolin e kostove të transaksioneve dhe asimetrive të informacionit në funksionimin e sistemit financiar e bankar, • funksionet themelore që i veçojnë bankat nga institucionet e tjera financiare, përfshi këtu rolin e veçantë në ekonominë e vendit, • diversifikimin e aseteve të bankave përmes sekjuritizimit, • bashkimet dhe blerjet dhe formimi i konglomerateve financiare, të cilat ndikojnë në ekonomi të shkallës dhe sinergjisë, • arsyet e rregullimit global të sektorit bankar, • njohja me zhvillimet e dixhitalizimit të shërbimeve dhe produkteve bankare, • funksionet dhe objektivat e menaxherëve dhe roli i rregullatorëve të bankave, • krizat bankare dhe mënyrat e tejkalimit të tyre, • çështjet e konkurrencës në bankingun e sotëm modern, • funksionimin e sektorit bankar kosovar si dhe burimet e të dhënave për sektorin në fjalë.

Rezultatet e pritura të lëndës

- Fitoj shkathtësi konkurruese teorike dhe praktike të aplikueshme në institucionet financiare (bankare dhe jo-bankare)
- Kuptoj funksionimin e sistemit financiar në përgjithësi e industrisë bankare në veçanti, duke analizuar sjelljen e tregueseve të ndryshëm të aktivitetit, performancës dhe rreziqeve me të cilat ballafaqohet sistemi bankar si dhe tregjet financiare
- Njoh strukturat e sistemit financiar dhe Menaxhmentit të bankave
- Kuptoj funksionimin e bankingut të sotëm, i përcjellur me shërbime dhe produkte bankare dixhitale
- Kuptoj rregullimin kombëtar dhe ndërkombëtar të bankave, që po rritet në vazhdimësi

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Pse të studiojmë paratë, bankat dhe tregjet financiare?	Ligjërata dhe Ushtrime
2	Kuptimi dhe sjellja e normave të interesit dhe Rreziku dhe struktura e normave të interesit	Ligjërata dhe Ushtrime
3	Tregu i kapitalit, Teoria e pritjeve racionale dhe hipotezat e tregut eficient	Ligjërata dhe Ushtrime
4	Analiza ekonomike e strukturës financiare dhe Bankingu e menaxhimi i institucioneve financiare	Ligjërata nga ekspertë të bankave
5	Analiza ekonomike e rregulloreve financiare	Ligjërata dhe Ushtrime
6	Industria bankare: struktura dhe konkurrenca	Ligjërata dhe Ushtrime
7	Banka Qendrore: roli, funksionet dhe organizimi	Ligjërata dhe Ushtrime
8	Procesi i ofertës së parasë dhe mjetet e politikës monetare	Ligjërata dhe Ushtrime
9	Menaxhimi i politikës monetare: strategjia dhe taktikat	Ligjërata dhe Ushtrime
10	Mekanizmi i transmisionit të politikës monetare	Ligjërata dhe Ushtrime

Vlerësimi:

Nr.	Lloji	Përqindja	Oblig.	Përshkrimi
1	Pjesëmarrja	10		Vlerësohet pjesëmarrja aktive dhe debatet/diskutimet në klasë
2	Ese	20		Ese e shkurtër në fushën e sistemeve financiare dhe bankingut
3	Provimi Final	70	Po	Kombinim i pyetjeve të shkurtëra dhe pyetjeve në formë të esesë.

Kushtet e përsëritjes:

Kushtet e përsëritjes së lëndës janë të bazuara në rregulloren e studimeve të Kolegjit Riinvest.

Burimet:

- 1. Mishkin, F.S., Serletis, A, 2020. The economics of money, banking, and financial markets. Seventh Canadian Edition 2. Cecchetti, S.G., Schoenholtz, K.L. and Fackler, J., 2017. Money, banking, and financial markets (Vol. 4). McGraw-Hill/Irwin. 3. Mishkin, F.S., 2016. The economics of money, banking, and financial markets. Eleventh Edition, Columbia University. 4. Hubbard, R. Glenn, O'Brien Anthony Patrick, and Sumati Varma. Money, banking, and the financial system. Boston: Pearson, 2014.

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	2	(i)
Ushtrime:	1	(i)
L+U:	30	(i)
Seminar/praktike.:	10	(i)
Studim i vazhdushem:	70	(i)
Pregaditja e Provimit:	60	(i)
Pjesemarrja ne teste:	0	(i)
Pjesemarrja ne provimin final:	2	(i)
Me profesorin dhe asistentin:	10	(i)
Total Ore:	182	(i)

ECTS: 8

